



Ftes për ofertë

Fondacionit Humanitar Golden Eagle është duke implementuar projektin “**Shpërndarja e pakove ushqimore për familjet në nevojë**”, qëllimin kryesor i këtij projekti është shpërndarja dhe furnizimi me pako ushqimore për familjet në nevojë. Ky grant është financuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në kuadër të Masës 3.4 – Pako ushqimore për familjet në nevojë në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Në kuadër të projektit Fondacionit Humanitar Golden Eagle ka paraparë blerjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë, ky aktivitet parashihet të zbatohet brenda 2 muajve. Përmes kësaj ftese Fondacionit Humanitar Golden Eagle fton kompanitë apo bizneset për dorëzim të ofertave për furnizim me pako ushqimore.

Specifikat e ofertës:

Pako ushqimore përmban produkte bazike të ushqimit, së paku 70% e vlerës të produkteve që përmban një pako ushqimore duhet të jenë produkte vendore (produkte me barkod 390). Numri i pakove që planifikojmë të furnizohemi nga ofertuesi është 980 -1000 pako.

1. Detajet për një pako ushqimore

Nr.	Emri i produktit	Paketimi	Sasia
1	Miell Gruri Tip 400	25 kg	1 thes
2	Vaj Luledielli	1 L	6 Copë
3	Sheqer i bardh	5 kg	1 Thes
4	Makarona	400 gr	6 Copë
5	Fasule	800 gr	3 Copë
6	Qumësht	1L	6 Copë
7	Krip Kuzhine	5 kg	1 Thes
8	Oriz i bardh	800 gr	2 Copë

Kushtet minimale për aplikim:

- Te jetë biznes i regjistruar dhe aktiv,
- Biznesi duhet të ketë aktivitet në fushën e tregtimit të produkteve ushqimore, furnizimit me produkte ushqimore apo te ngjashme,
- Te jetë në gjendje të ofroj pakon sipas specifikacionit dhe sasinë e pakove ushqimore brenda 2 muajve.

Ofertuesit që plotësojnë kushtet minimale, përzgjidhen si ofertues të rregullt, ndërsa ofertuesi me çmim më të ulët për pako do të kontraktohet për implementim të aktivitetit.

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

- Certifikata e biznesit të gjitha fletët,
- Oferta,
- Llogari bankare në emër të biznesit,

Koha dhe mënyra e aplikimit:

Koha e aplikimit është e hapur prej datës 30.05.2022 deri me 06.06.2022, ora e mbylljes për aplikim 16:00.

Aplikimi mund të behet përmes postes elektronike me subjekt “**Ofertë për pako ushqimore**” Info@goldeneagle-ks.com duke ngarkuar dokumentet e kërkuar për aplikim.